



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMUNA GRUEMIRE
MALESI E MADHE

Adresa: Gruemire- Qendër, Malesi e Madhe

e-mail: gruemirekomuna@yahoo.com



Gruemire, me 30/09/2014

KONTRATE SIPERMARRJE
PUNE PUBLIKE

E lidhur sot me date 30/09/2014 ne mes paleve Komuna Gruemire Malesi e Madhe perfaqesuar nga Z. Lirim Nebanaj, Titullar i Autoritetit Kontraktues, dhe

Shoqerise ndertuese "STERKAJ"sh.p.k perfaqesuar nga Z. Lulzim Sterkaj administrator i shoqerise, me adrese:: Dedaj, Komuna Shkrel, Malesi e Madhe, nr. Nipti- J68310708M, , me tager dhe kompetence te plotë për të vepruar dhe përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet me investitorin, i quajtur me poshte " Kontraktuesi";

Neni 1
Baza Ligjore

1. Kodi Civil me ndryshimet perkatese, pjesa V-^{le} " Kontratat" titulli i I-^{re} (kreu I –kreu III), titulli i II-^{le} (kreu VII), neni 850 e në vijim.
2. Ligji nr.9643, dt.20.11.2006 " Per Prokurimin Publik", (i ndryshuar).
3. VKM nr.1, dt. 10.01.2007 " Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", (te ndryshuar).
4. Ligji nr. 8402, dt. 10.09.1998 "Per Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve te Ndertimit"; Udhezim i K.M nr.2, dt. 13.05.2005 " Per Zbatimin e Punimeve te Ndertimit".

Neni 1
Objekti i kontrates

Shoqeria "STERKAJ"sh.p.k merr persiper kryerjen e punimeve ne objektin :
"Rikonstruksion i shkolles se Mesme te bashkuar Gruemire, Komuna Gruemire "



Neni 2 Perkufizime

- 2.1 "Formulari i ofertes" është dokumenti që sipermarrësi ka dorëzuar në datën e zhvillimit të garës dhe është pranuar nga Investitori.
- 2.2 "Vlera e kontrates" është vlera e dhënë në njoftimin e fituesit, që Autoriteti Kontraktor i ka dërguar kontraktori fitues mbi bazën e të cilës është plotësuar e dorëzuar formulari i kontrates, nga ky i fundit.
- 2.3 "Afati i realizimit të punimeve" do të thotë data që Punët duhet të përfundojnë siç është shprehur në Grafikonin për realizimin Punimeve, e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor.
- 2.4 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.6 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e pa përfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.7 "Ditët" janë kalendarike, muajt janë kalendarike.
- 2.8 "Data e fillimit" është përfshirë në të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndërtimit. Nëse kjo nuk realizohet, "data e fillimit" do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.9 "Ndryshime" janë udhëzime që jep Autoriteti Kontraktor i parashikuar në dokumentat fillestare dhe jepet gjithmonë me shkrim.
- 2.10 "Preventiv" për njësi, janë vëllimet e punës të plotësuar me çmime, pjesë përbërëse të ofertes.
- 2.11 "Raste të kompensuar" janë ndalesat paraprake në situacione.
- 2.12 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella për kohësisht në kanton për realizimin e Ndërtimeve.
- 2.13 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.14 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.15 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.16 "Drejtuues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.



- 2.17 "Inxhnieri zbatues" është person i aprovuar nga Autoriteti Kontrakt, përfaqësues i ofertuesit ekonomik, përgjegjës për kryerjen dhe perfundimin e punimeve. për të cilin sipërmarrësi është i detyruar t'i konfirmojë Autoritetit Kontraktor emrin e tij.
- 2.18 "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktin punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.19 "Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.20 "Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.21 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.22 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.23 "Personeli" stafi i deklaruar në oferte për zbatimin e kontrates.
- 2.24 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.25 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.26 "Punime ndertimi" janë ato punime që duhet të kryhen nga operatori ekonomik në përputhje me kontratën dhe t'ia dorëzojë Autoritetit Kontraktor me perfundimin e tyre.
- 2.27 "Situacion" quhet dokumenti i evidentimit faktik të situatës së punës së kryer në përputhje me zërat e punimeve të përcaktuar në kontrate (volumeve), në përputhje me procesverbalet ditore. Situacionet janë ditore, mujore dhe vjetore.
- 2.28 "Procesverbal" quhet dokumenti i hartuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor mbi kontrollin e ushtruar në terren që reflekton punën e pakryer, gjërat dhe penalitetet e vendosura në përputhje me kushtet e kontrates dhe problemet e konstatuara gjatë kontrollit.

Neni 3

Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.



Neni 4
Vlera e kontrates

Vlera e kesaj kontrate eshte ne shumen totale prej: 22 195 654 (Njzetedymilion e njeqindneentehjeteepesemije e gjashteqindepesedhjeteekater) leke **lekë me T.V.SH**
Ne kete vlere jane te perfshira te gjitha detyrimet fiskale te percaktuara ne legjislacionin shqiptar.
Çmimet e kontraktorit për punët e kryera sipas kontrates nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga kontraktori në oferten e tij.

Kjo kontrate do te çmohet si kontrate me Çmim Njesie te bazuar ne çmimet e njesise te shprehura ne preventivin ne njesi.

Kjo kontrate financohet nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve.

Per vitin 2014 vlere e financimit eshte 10 601 502 leke me tvsh,

ndersa pjesa tjetere prej 11 594 152 leke me tvsh do financohet gjate vitit 2015.

Neni 5
Afati i kryerjes se punimeve

Afati i kryerjes se ketyre punimeve eshte 45 (Katerdhjete e pese) dite dhe llogaritet nga data e nenshkrimtit te kontrates.

Neni 6
Kantieri i punimeve

Punimet do të kryhen në fshatin Gruemire ne Shkollen e mesme te bashkuar Gruemire, Komuna Gruemire ”

Neni 7
Personeli

- 1.Kontraktori duhet të punësojë vetëm personelin e deklaruar në ofertë për zbatimin e punimeve të parashikuara në programin e miratuar nga drejtoria i projektit.
- 2.Drejtuksi ligjor dhe teknik të operatorit ekonomik janë përgjegjës para autoritetit Kontraktor për ndërtimin e vepres, sipas projektit, për kryerjen e punimeve në përputhje me specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
- 3.Drejtuksi teknik i punimeve sigurohet drejtëperdrejte nga drejtuksi teknik i operatorit ekonomik ose përgjegjesi teknik i kantierit.
- 4.Drejtuksi i Projektit do të miratoje çdo propozim te kontraktorit për të zevendësuar personelin kryesor vetëm nqs kualifikimet dhe aftësitë e tyre janë të njëjta ose më të larta me ato te stafit te percaktuar në oferte.

Neni 8
Ndryshime të Urdhëruara

- a.Kontraktori nuk mund të ndryshojë me nismen e vet, të subjektit projektues apo mbikqyres, projektin dhe pershkimet teknike te tij.



- b. Çdo ndryshim i urdheruar nga Autoriteti Kontraktor i cili në asnjë rast nuk duhet të sjellë rritje të vlerës së kontrates, do të jetë detyrimisht objekt i një procesverballi me shkrim i nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor. Këto urdhera do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe në bazë të llogarisë përkatëse të bërë nga kontraktori dhe të miratuar nga drejtuesi i projektit e projektuesi mbeshtetur në çmimin për njësi për çdo zë pune shprehur në preventivin e ofertes fituese.
- c. Kontraktori është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdheruar me shkrim i firmosur nga Autoriteti Kontraktor që nuk ndryshon, në thelb specifikimet e projektit, ato të kontrates dhe nuk rrit vlerën e saj.
- d. Propozimet për rritjen e vlerës së kontrates dhe për zgjatjen e afateve të punimeve i paraqiten Autoritetit Kontraktor, nëpërmjet mbikqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e vepres, vijnë nga shkaqë pamundësisht të parashikueshme, në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me dispozitat e kontrates.
- e. Ndryshimet e miratuara nga Autoriteti Kontraktor sipas dispozitave të përmendura me sipër, sëbashku me dokumentacionin e nevojshëm teknik, ekonomik e administrativ, i dorëzon zyrtarisht kontraktori.

Neni 9 Rreziqet e Operatorit Ekonomik

Nga data e fillimit deri në fund të periudhës së përfundimit të punimeve për defektet që jepen në të dhënat e kontrates, operatori ekonomik do të përballojë rreziqet për shkak të dëmtimeve personale, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshi punimet, materialet dhe pajisjet).

Neni 10 Sigurimet


10.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit të Plote, në shumën e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

10.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

10.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 11 Kontraktori që do të kryejë punimet

- a. Kontraktori do të kryejë punimet në përputhje me projektet e dhëna nga Autoriteti Kontraktor dhe në përputhje me specifikimet teknike.
- b. Kontraktori detyrohet të zbatojë punimet në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit. Përbajtja e kontrates nuk



- është mjet për të shmangur zbatimin e standarteve dhe të rregullave teknike në fuqi.
- c. Kontraktori ruan dhe nuk lejon përdorimin apo kalimin e pronesisë të dokumentave, që i vë në dispozicion Autoriteti Kontraktor, të persona të paautorizuar.
- d. Kontraktori gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës paraqet kërkesë-provizimet për korigjime, plotësime apo përmirësime në projekt dhe për mungesat e pasaktësitë, ligjore apo kontraktuale të dokumentacionit të dorëzuar.
- e. Kontraktori, me kërkesë të mbikqyresit, programon kryerjen e punimeve, për çdo muaj dhe korigjon elemente të projekt organizimit për mospermbushje të kushteve themelore të kontratës.
- f. Projekt organizimi i punimeve përmban planin e ngritjes dhe të organizimit të kantierit, për ndërtimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet dhe afatet e kontratës.
- g. Kontraktori kryen punime të veçanta, të parashikuara në kontratë me nënkontraktim, vetëm me miratim paraprak të Autoritetit Kontraktor. Marrdhëniet dhe kushtet e nënkontraktimit rregullohen me marrëveshje dypalëshe, përmbajtja e së cilës në asnjë rast nuk duhet të vijë në kundërshtim me detyrimet kontraktore të operatorit ekonomik. Kontraktori mbetet përgjegjës për çdo rast për punimet e kryera me nënkontraktim si dhe për dokumentacionin teknik, ekonomik dhe administrativ.
- h. Nënkontraktori i punimeve të veçanta të ndërtimit duhet të plotësojë kushtet e një subjekti të mirëfilltë për zbatim punimesh.
- i. Kur Autoriteti Kontraktor bindet se operatori ekonomik shkel kushtet e kontratës, lajmëron me shkrim kontraktorin për zgjidhjen e kontratës dhe largimin e nënkontraktorit.
- j. Kontraktori jo më pak se 10 ditë para fillimit të punimeve, njofton me shkrim seksionin e urbanistikës që ka lëshuar lejen dhe në degen rajonale të Policisë Ndërtimore. Në njoftim jepen të dhëna për objektin, Autoritetin Kontraktor/ofertuesin ekonomik, subjektin projektues e mbikqyres, dokumentacionin administrativo-ligjor të miratuar dhe stafin drejtues të kantierit.

Neni 12 Specifikimet Teknike

Kontrata bazohet në specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor (njësia e prokurimit dhe që pranohen shprehimisht nga palet. Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse aneksi i kontratës.

Neni 13 Sigurimi Teknik

Kontraktori është përgjegjës për të gjitha veprimet e bëra në kantierin e ndërtimit, duke zbatuar masat korigjuese teknike për të gjithë personelin.

Kontraktori është përgjegjës për kontrollin dhe respektimin e kërkesave të kontratës për cilësinë e punimeve. Ai është i detyruar të kryejë të gjitha provat dhe inspektimet në punimet e ndryshme të ndërtimit, të detyrueshme nga kushtet teknike në fuqi.

Kontraktori detyrohet të sigurojë në kantier:

1. punëmarrës të aftë për punë me lejet perkatese për ushtrimin e profesioneve të caktuara.
2. materiale, pajisje, mjete mbrojtëse dhe tabela paralajmëruese.
3. kontroll periodik dhe mirëmbajtje të mjeteve e makinarive të instaluar në kantier, për punë në rrazik.
4. rregullore dhe urdheresa për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë.



Neni 14



Korigjimi i Defekteve

Drejtuesi i projektit do të njoftojë kontraktorin lidhur me defektet që konstatohen para mbarimit të periudhës së garancisë për defektet.

Çdo herë që njoftohet defekt, kontraktori do të korigjojë defektin brenda afatit të parashikuar nga njoftimi i drejtuesit të projektit.

Neni 15 Defektet e pakorrigjuara

Nese kontraktori nuk e ka korigjuar nje defekt brenda kohes se specifikuar ne njoftimin per defektin nga Drejtuesi i projektit, Drejtuesi i projektit do te llogarise koston e korigjimit te defektit dhe kjo shume do te mbahet nga çdo pagese qe i duhet bere kontraktorit deri sa defekti te korigjohet. Deshtimi per te korigjuar defektin brenda nje afati te arsyeshem perben shkak per zgjidhje kontrate per arsye mospermbushje ne favor te Autoritetit Kontraktor.

Neni -16 Raste te Kompensuara

Raste te kompensuara pet te cilat vonesa justifikohet do te konsiderohen:

1. Drejtoria e punimeve urdheron shtyerjen ose nuk jep skicat (specifikimet e nevojshme per kryerjen e punimeve) ne kohen e caktuar.
2. Drejtoria e punimeve udhezoi kontraktorin per te zbuluar punimeve te fshehta ose per te kryer provat para kryerjes së punimeve.
3. Autoriteti Kontraktor shkakton vonesa ose shpenzime shtese per kontraktorin.
4. Vonesa e pagesave të radhes per çdo vërtetim punimesh.
5. Autoriteti Kontraktor vonon pa arsye lëshimin e çertifikates se marrjes në dorëzim të punimeve

Kompensimi i rasteve do te bëhet si më poshtë:

1. Per vonesat e permendura ne tre pikat e para te paragrafit te mesiperm.
2. Autoriteti Kontraktor do te njoftojë shlyerjen e datës mbi atë të parashikuar ne kontrate.
3. Për dy pikat e fundit në veçanti do të njohë edhe shpenzimet eventuale.

Neni 17 Taksat

Kontraktori duhet të shlyeje të gjitha detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 18 Ndalesat, Penalitetet dhe Gjobat.

Kontraktori duhet të zhdëmtojë Autoritetin Kontraktor per çdo dëm të shkaktuar me faj të tij.

Kontraktori i nënshtrohet ndalesave dhe penaliteteve për punë të pakryer si më poshtë:



1. Në raste kur identifikohenzëra të punës së pakryer, të parashikuar nga preventivi i kontrates, atëherë përveç ndaleses për punë të pakryer, Kontraktori do të penalizohet me 5-fishin e vlerës së zërit përkatës.
2. Në rastin kur kontraktori nuk kryen me cilësinë e kërkuar nga specifikimet teknike të kontrates shërbimin e proceseve të parashikuar për ndonjë zë pune, Kontraktori do të penalizohet me 2-fishin e vlerës së zërit përkatës.
3. Kontraktori është i detyruar që të mos angazhojë punëtorë të tjerë jo të shoqërisë. Punonjësit e shoqërisë duhet të vishen me uniforme ku të percaktohen qarte shënjat dalluese të operatorit ekonomik. Në rastin e mosrespektimit të këtij detyrimi, Supervizori bën njoftimin përkatës dhe në rast se kontraktori nuk vepron brenda 5 diteve nga dita e marrjes së njoftimit, Supervizori aplikon gjobë në masën 50.000 deri në 200.000 lekë.

Neni 19 Dëshmëpërblimi për Vonesat

Kontraktori do t'i paguajë Autoritetit Kontraktor dëshmëpërblim për vonesa me tarife ditore prej 4/1000 e Kontraktori do t'i paguajë Autoritetit Kontraktor dëshmëpërblim për vonesa me tarife ditore prej 4/1000 e çmimit total të kontrates.

Sasia e pergjithshme e dëmeve të likuiduara nuk do të kalojë 25% të vlerës së kontrates. Autoriteti Kontraktor do të zbresë dëshmëpërblim për vonesat nga pagesa e fundit e operatorit ekonomik e percaktuar nga drejtuesi i projektit dhënë për likuidim Autoriteti Kontraktor.

Neni 20 Kostoja e Riparimeve


Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punime nga data e fillimit deri në marrjen në dorëzim të punimeve do të mbulohet nga kontraktori me shpenzimet e tij n.q.s dëmi ose humbja janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit nëse janë shkak të mos plotësimit të kontrates ose të punës jo cilësore të operatorit ekonomik do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës për likuidimin e dëmeve të shkaktuara nga forcat madhore si termetet, permbytjet ose gjendje e jashtëzakonshme që mund të ndodhë gjatë zbatimit të punimeve, të cilat nuk mund të kontrollohen nga kontraktori dhe që nuk konsiderohen si neglizhencë e tij.

Neni 21 Ekzekutimi i Punimeve

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontrates menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet të mbarojë punët brenda Afatit të Mbarimit.



Neni 22 Disponimi i kantierit

Autoriteti Kontraktor duhet ti jape te drejten e disponimit te kantierit kontraktorit ne daten e nenshkrimit te kontrates. Nese disponimi i ndonje pjese te kantierit nuk jepet brenda dates se hyrjes per kantierin ose asaj pjese te kantierit siç parashikohet me siper , do te konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit te kontrates , dhe kontraktorit i lind e drejta te kerkoje

amendimin e kontrates ne lidhje me shtyrjen e Afatit te Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do te mbajne procesverbal per daten e hyrjes

Neni 23 Drejtuesi i Projektit

Drejtuesi i projektit eshte person i emeruar nga Autoriteti Kontraktor qe eshte pergjegjes per administrimin e kontrates per Autoritetin Kontraktor. Drejtuesi i projektit do te vendose per çeshjtjet e Kontrates midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

Neni 24 Preventivi

Preventivi duhet te permbaje zerat e punimeve te ndertimit, te instalimeve dhe provat qe duhet te kryhen nga sipermarresi. Preventivi sherben per te llogaritur vleren e kontrates. Kontraktuesi paguhet per volumin e punes se kryer konform projektit duke u bazuar ne çmimet per njesi te percaktuara ne preventive per çdo ze pune.

Neni 25 Situacionet

Kontraktuesi do t'i dorëzoje Drejtuesit te projektit situacionet mujore per punimet e kryera. Drejtuesi i projektit duhet te kontrolloje punen e kryer nga Kontraktuesi dhe duhet te vertetoje shumen qe duhet t'i paguhet Kontraktuesit brenda 20 diteve nga paraqitja e situacionit. Vlera e punes se kryer do te perfshije vleren e volumeve te perfunduara sipas çmimeve te zerave te punes te dhena ne preventiv.

Neni 26 Pagesa

Pagesa duhet bere sipas grafikut te meposhtem: situacion pjesore dhe Situacion perfundimtar. Pagesa per punet duhet bere brenda 30 diteve nga data qe Kontraktori paraqet nje dokument qe deklaroi se objektivi per pagesen eshte arritur subjekt ky i konfirmimit te dokumentit nga drejtuesi i projektit. Monedha e pageses do te jete leke.

Kontraktuesi nuk ka të drejtë të pretendojë nga Autoriteti Kontraktor (Institucioni që lidh kontraten) asnjë dëmshperblim për mosfinancimin në kohë të punimeve në rastin e çeljes me vonesë të fondeve.



Neni 27
Mbarimi dhe marrja ne dorezim e punimeve

Kontraktori duhet ti kerkoje Drejtuesit te projektit ti leshoje nje certificate per mbarimin e punimeve dhe Drejtuesit te projektit do ta beje kete sapo te vendosi se punimet jane mbaruar plotesisht. Nese Drejtuesit te projektit zbulon se punimet nuk jane perfunduar plotesisht, Drejtuesit te projektit do ti jape udhezime me shkrim kontraktorit qe specifikojne zerat e punimeve ose aktivitetet qe duhen pefunduar para se te leshohet certifikata. Nese Drejtuesi i projektit zbulon difekte ne punime, Drejtuesi i projektit duhet ti jape Kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuuar difektet qe duhet te korigjohen para se te leshohet certifikata.

Neni 28
Vonesa ne zbatim dhe zgjatja e afatit

Autoriteti Kontraktor, me perjashtim te rastit kur eshte dakort per zgjatje te afatit te kontrates ka te drejte te te kerkoje demet per vonesen ne zbatim, nese kontraktori deshton ne dorezimin e punes Brenda afatit te dorezimit te plote te specifikuuar ne kontrate. Autoriteti Kontraktor mund te zbrese ne shumen e demeve te likujdueshme qe duhen paguar nga shuma e pageses ndaj kontraktorit. Ne rast te tille Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim per shumen dhe arsyen e zbritjes. Autoriteti Kontraktor do te jete dakort per nje zgjatje te afatit, ne rastin e Forces Madhore. Autoriteti Kontraktor, mund te jete dakort per zgjatje te afatit edhe ne rrethana te tjera nese eshte ne interesin publik per ta bere kete. Në rast se kontraktori me kushte që pengojne zbatimin në kohë, vonesën, shkakun dhe daten e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontrates të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.


Neni 29
Ndërprerja për Mosplotësim

29.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

29.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

29.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj.



Neni 30

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

30.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

30.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 31

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

31.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

31.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të

Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet

Neni 33

Negociatat dhe Amendamentet

Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontrates që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazen e përzgjedhjes së kontraktorit.

Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontrates nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontrates dhe nënshkruhet nga nje përfaqësues i autorizuar i Kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

Neni 34

Ndryshimi i porosisë

Ndërtime shtesë mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuara në LPP dhe me kusht që shtesa e kontrates të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontrates.

Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë Kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontrates në secilin nga elementë të mëposhtëm:

- a. Korigjime në projektin, vizatimin ose specifkimet e Punëve.
- b. Korigjime në materiale
- c. Korigjime në sasi

Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontrates dhe /ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes.

Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit 18 të Kontrates.

Neni 35 Prishja e Kontrates

Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë Kontraten në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktori nuk fillon punën menjëherë pas dates së dhënies të lejes së ndërtimit dhe të hartimit të procesverbalit të dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
- b) Kontraktori ndalon punimet për 15 ditë kur nuk është parashikuar ndërprerja e tyre në programin e punimeve të miratuara dhe kur drejtuesi i projektit nuk ka autorizuar ndërprerjen e tyre.
- c) Drejtuesi i projektit udhëzon pezullimin e punimeve dhe ky udhëzim nuk terhiqet prej tij brenda 15 ditëve ose nuk arrihet marrveshja për pagimin e kostos të shtyrjes nga kontraktori.
- d) Kontraktori falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindertimit ose bashkimit të shoqërisë.
- e) Kontraktori vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korigjimet e propozuara nga drejtuesi i projektit.
- f) Drejtuesi i projektit dërgon njoftimin se moskorigjimi i një defekti të posaçëm paraqet shkelje themelore të kontrates dhe operatori ekonomik nuk e korigjon atë brenda 30 ditëve të përcaktuara nga drejtuesi i projektit

Kur Kontraktori ekonomik njofton Autoritetin Kontraktor për shkelje të kontrates për ndonjë shkak përveç ndryshimit të kostos si rrjedhim i ndryshimit të legjislacionit, është e drejta e autoritetit kontraktor të vendosë nëse shkelja është themelore apo jo. Kur ndërprerja e kontrates është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, prishja do të jetë e menjëherëshme. Autoriteti Kontraktor kur ka arsye objektive mund të prishë kontraten duke i dhënë kontraktorit një njoftim me shkrim brenda një afati prej 30 ditësh.

Neni 36 Pasojat e Prishjes së Kontrates

- a. Në rast se kontrata prishet për shkelje themelore nga ana e kontraktorit, drejtuesi i punimeve do të lëshojë një çertifikate pagese për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e mëparshme, vlerën e plote të paradhënies dhe vlerën e garancisë së cilësisë së punimeve të realizuara.
- b. Në rast se kontrata prishet për shkelje themelore nga ana e kontraktorit ose për arsye të tjera objektive, drejtuesi i punimeve do të lëshojë një çertifikate pagese për vlerën e punës së kryer, për vlerën e prodhimeve të gatshme me të cilat është furnizuar objekti, për shpenzimet e kontraktorit për mbrojtjen dhe sigurimin e punimeve duke zbritur pagesat e marra deri në ditën e lëshimit të saj sipas pragrafit të mësipërm.
- c. Në rastet e prishjes së kontrates për shkak të kontraktorit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të sekuestrojë garancinë e kontrates në masën e caktuar në kontratë.
- d. Në rastet e prishjes së kontrates për shkak të kontraktorit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë gjithashtu t'i kërkojë dëmshpërblim operatorit ekonomik (kontraktorit) në masën e dëmit të shkaktuar.



Neni 37
Pasuria

Të gjitha punimet e kryera do të konsiderohen pronë e Autoritetit Kontraktor në rast të ndërprerjes së Kontrates.

Neni 38
Sigurimi i Kontrates

Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të shkaktuar nga dështimi i Kontraktorit në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontrates.

50% e garancisë së kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas dates së marrjes së perkohëshme në dorëzim, ndërsa pjesa tjetër (50%) e depozites do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të periudhes së garancisë.

Afati i garancisë do të jetë një vit dhe do të llogaritet pas lëshimit të Aktit të marrjes së perkohëshme në dorëzim.

Neni 39
Garancia e te Metave te Sendit

Afati i garancisë për të metat apo deformimet e vepres është 12 muaj pas kolaudimit përfundimtar të objektit.

Neni 40
Monitorimi i Kontrates

Autoriteti Kontraktor në kuptim të nenit 62, të ligjit për nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar) si dhe Kreut III, pika 2 të VKM nr.1 dt.10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik" (të ndryshuar), në çdo rast mund të ushtroje kontrolle për zbatimin e kontrates ose lëvrimet, dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, zbaton penalitetet e parashikuara në kontrate

Neni 41
Testimet dhe Inspektimet

1. Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontrates. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontrates.
2. Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet/ inspektimet. Nëse materialet prodhohet ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, ky i fundit duhet të marrë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto inspektime dhe teste.
3. Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë inspektime dhe teste shtese të parashikuara në kontrate por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontrates. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.
4. Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin ose që nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kontrates.
5. As ekzekutimi i testeve dhe as inspektimi nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontrates.



Neni 42
Raportimi i Grafikut te Punimeve

Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 43
Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas Kontrates duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 44
Pjesë përbërëse të kontrates

Kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontrates si dhe dokumentat e tenderit do të jenë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Neni 45
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve, do të zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt zgjidhja e tyre do të jetë kompetencë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder.

Neni 46
Vlefshmëria e Kontrates

- Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët kontraktore.
- Kjo kontratë u hartua në katër kopje, tre prej të cilave i mban Autoriteti Kontraktor dhe një kopje vihet në dispozicion të Kontraktuesit.

INVESTITORI

Komuna Gruemire

Kryetar
Lirim NEHANAJ



SIPERMARRESI

Shoqëria "STERKAJ" sh.p.k

Perfaqesues:
Lulzim STERKAJ

